VENDIM
Nr.723, datë 5.11.2004

PËR PROCEDURAT DHE RREGULLAT BAZË TË FUNKSIONIMIT TË ORGANIZMIT TË AUTORIZUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "b" e "c" të nenit 10 të ligjit nr.9097, datë 3.7.2003 "Për vlerësimin e konformitetit", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vlerësimi i konformitetit kryhet nga organizmi i autorizuar, në përputhje me procedurat e mëposhtme:

a) marrja e mostrës, sipas standardeve përkatëse në fuqi, dhe paraqitja e produktit për ekzaminimin e tipit;

b) kryerja e provave sipas metodikave të standardizuara;

c) inspektimi, vlerësimi, verifikimi dhe certifikimi i produktit, në bazë të rezultateve të provave.

2. Prodhuesi i produktit dhe/ose importuesi i lëndëve të para, për të kryer vlerësimin e konformitetit, duhet t'i paraqesë organizmit të autorizuar të dhënat për identitetin e subjektit, vendin e prodhimit të produktit dhe dokumentacionin teknik, i cili përmban:

a) përshkrimin e përgjithshëm të produktit;

b) vizatimet e produktit, skemën e konstruksionit, pjesët përbërëse, përbërjen e produktit, procesin teknologjik, mbrojtjen nga zjarri, karakteristikat kimike, fizike e biologjike për mbrojtjen e shëndetit të njeriut e të kafshëve dhe për mbrojtjen e mjedisit natyror;

c) përshkrimin dhe sqarimet e domosdoshme për leximin e vizatimeve, të skemave, instruksionet për përdorim, përfshirë edhe kërkesat e shërbimit dhe shënimet për karakteristikat e mbrojtjes nga zjarri;

ç) paralajmërimet për rreziqet dhe instruksionet për sigurinë e përdorimit, të shkruara qartë dhe në vend të dukshëm në produkt ose në ambalazhin e tij;

d) standardin ose rregullin teknik, të cilit i referohet prodhimi i produktit;

e) përfundimet e llogaritjeve dhe të analizave;

ë) protokollet e kontrollit dhe certifikatat.

3. Deklarimi i konformitetit të produktit me kërkesat teknike dëshmohet nga deklarata e konformitetit, e cila përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit ose të të autorizuarit prej tij;

b) përshkrimin e produktit (tipin, identifikimin, përdorimin);

c) kërkesat teknike, me të cilat produkti është në konformitet;

ç) kushtet e veçanta, të vlefshme për përdorimin e produktit;

d) organizmin e autorizuar, që ka kryer vlerësimin e konformitetit.

4. Hedhja në treg e produktit të sferës së detyruar bëhet pasi të jetë kryer vlerësimi i konformitetit, që vërtetohet me inicialet SL (sipas ligjit), të vendosura nga prodhuesi mbi produkt, pas deklarimit të konformitetit, në përputhje me kërkesat teknike, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit regjistron dhe depoziton SL-në në Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

6. Nëse ka ndryshime nga deklarimi i konformitetit të produktit ndaj kërkesave themelore të tij, atëherë duhet bërë deklarim i ri konformiteti, duke përfshirë në deklaratë edhe shtesat përkatëse.

7. Subjektet që i hedhin produktet në treg, kanë detyrë ta ruajnë dokumentacionin teknik për të paktën 10 vjet nga data e prodhimit të fundit ose për një periudhë tjetër, nëse është specifikuar ndryshe në kërkesat teknike.

8. Për t'u miratuar nga Këshilli i Ministrave, organizmi që kërkon të kryejë vlerësimin e konformitetit, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse një kërkesë me shkrim, si dhe të plotësojë kushtet e kriteret e mëposhtme:

a) Të jetë i regjistruar në gjykatë si person fizik a juridik. Kur organizmi i interesuar është institucion publik, duhet të paraqesë aktin e krijimit të tij;

b) Të jetë i pajisur me certifikatën e akreditimit, për fushën përkatëse, ku do të kryejë vlerësimin e konformitetit, të lëshuar nga Drejtoria e Akreditimit;

c) Të ketë specialistë me arsim të lartë, të pajisur me dëshmitë përkatëse, në fushën ku kërkon të kryejë vlerësimin e konformitetit;

ç) Të deklarojë se nuk ka konflikt interesash në fushën ku kërkon të kryejë vlerësimin e konformitetit;

d) Të paraqesë dokumentin bankar, për të vërtetuar se ka burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e kësaj veprimtarie.

9. Kërkesa shqyrtohet nga ministri përgjegjës, sipas fushës së veprimtarisë që mbulon, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim, dhe dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave.

Kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 8 të këtij vendimi, kërkesa refuzohet me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit ose sugjerimet përkatëse, për plotësimin e mangësive.

10. Pas miratimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit, ministri përgjegjës apo institucioni qendror lëshon autorizimin përkatës, për një afat 3-vjeçar, me të drejtë rinovimi.

Autorizimi përmban:

a) emërtimin e organizmit dhe adresën;

b) datën e miratimit të kërkesës, e cila është edhe data e fillimit të afatit të autorizimit;

c) objektet e veprimtarisë në fushën konkrete të vlerësimit të konformitetit.

11. Autorizimi pezullohet nga ministri përgjegjës apo institucioni qendror, për një afat 3 deri 6-mujor, në rastet kur organizmi i autorizuar shkel kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë vendim. Në rast se shkeljet nuk rregullohen brenda afatit të caktuar, ministri përgjegjës i propozon Këshillit të Ministrave shfuqizimin e vendimit, që ka miratuar organizmin e autorizuar.

Për çdo dhënie, pezullim apo ndryshim në autorizim, dërgohet njoftim me shkrim në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, e cila mban një regjistër për të gjitha të dhënat e shënuara në autorizimin përkatës.

12.Organizmi i autorizuar, brenda natës 30 janar të çdo viti, paraqet, për çdo veprimtari të kryer, të dhëna ose një raport pranë ministrisë apo institucionit qendror përkatës.

13. Të gjitha shpenzimet e organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit të përballohen nga prodhuesi i produktit apo importuesi i lëndëve të para.

14. Organizmi përkatës i autorizuar, kur vëren se prodhimi i produktit nuk është në konformitet me kërkesat teknike, njofton ministrinë përkatëse dhe organin përgjegjës për marrjen e masave në mbrojtje të konsumatorit, në përputhje me ligjin nr.9135, datë 11.9.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

15. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano